

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6240
E hënë, 15 shkurt 2021
çmimi 0.40

Çfarë duhet të dini për vaksinën e "AstraZenecas" të cilën e pret Kosova

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA MBAJTI MË 14 SHKURT ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE

VETËVENDOSJE FITUESE E ZGJEDHJEVE



Në bazë të rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje ka fituar zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit me

rreth 48 për qind të votave. Pas IV-së është radhitur e dyta, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me rreth 17 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

me 13 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.45 për qind, ndërkohë Nisma Socialdemokrate nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor prej 5 për qind

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIPIP KAMBERI

QEVERIA E RE TA PËRFSHIJË ÇËSHTJEN E LUGINËS NË DIALOGUN ME SERBINË



Deputeti shqiptar në parlamentin e Serbisë, Shqipëri Kamberi, ka bërë me dije se qeveria e re e Kosovës, e cila do të dalë nga zgjedhjet e 14 shkurtit, duhet ta përfshijë çështjen e Luginës në dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kjo është mundësia e fundit për të ndikuar në përmirësimin e pozitës së shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Kamberi ka kritikuar Gjykatën e Lartë në Beograd që ka refuzuar ta shpallë fajtor ministrin Aleksandër Vulin për gjuhën e urrejtjes ndaj shqiptarëve. Sipas tij, ky është një precedent i rrezikshëm i cili e kthen Serbinë në periudhën e Aleksandër Rankoviçit

KOSNETTI: I TAKON POPULLIT TË KOSOVËS TË VENDOSË SE SI DO TË DUKET QEVERIA E RE



OPINION

ZGJEDHJET NË SHQIPËRI, KAMBANAT PO BIEN ME TË MADHE F. 11

Nga Bedri ISLAMI



AKTUALE



NGA 3 031 TESTIME, 246 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 7

ARKIVI HISTORIK I PODUJEVËS ZHVENDOSSET NË ISH-OBJEKTIN E KOMUNES F. 10

SHEFI I BE-SË: JEMI KËTU PËR TA MBËSHTETUR KOSOVËN NË PËRPPJEKJET E SAJ F. 7

EKONOMI



HIDROCENTRALET, PROBLEM I MADH I KOSOVËS F. 9

GUVERNATORI I BQK-së: QEVERIA E ARDHSHME FOKUS DUHET TA KETË EKONOMINË F. 9

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...



Senati shpall të pafajshëm ish-presidentin Trump

Uashington, 14 shkurt - Senati amerikan ka votuar për ta shpallur të pafajshëm ish-presidentin Donald Trump nën akuzën për nxitje rebelimi të ngritur nga Dhoma e Përfaqësuesve. Senati votoi me 57 vota për ta shpallur ish-presidentin fajtor dhe 43 jo fajtor. Meqenëse në

një gjyq në Senat kërkoheshin 67 vota, ose dy të tretat për fajësimin, ish-presidenti Trump u shpall i pafajshëm. Shtatë republikanë u shkëputën nga radhët e grupit të tyre dhe votuan pro fajësimin. Është hera e dytë në 12 muaj që Trumpi i mbijeton një gjyqi

në Senat kundër tij. Demokratët synonin që ai të mos lejohej të kandidonte përsëri për një post publik. Trumpi u largua nga Shtëpia e Bardhë më 20 janar, prandaj ishte e qartë se ngritja e akuzës për nxitje rebelimi kundër tij nuk do të përdorej dot për heqjen e tij nga detyra.

Wesley Clark: Administrata Biden do t'i kushtojë vëmendje Ballkanit

Nju-Jork, 14 shkurt - Ish-komandanti i lartë i NATO-s, Wesley Clark, ka thënë se një njohje e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë është rruga drejt përparimit dhe integritimit

dhe se kjo sjell përfitime për të dyja vendet. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Clark ka thënë se administrata e re e presidentit Joe Biden do ta shtojë vëmendjen ndaj Evropës

Juglindore dhe Ballkanit. Gjenerali në pension ka pohuar se zhvillimet e fundit politike në Amerikë, tregojnë forcën e demokracisë dhe jo dobësinë e saj.



Izraeli gradualisht po u jep fund masave të izolimit



Jerusalem, 14 shkurt - Izraeli po planifikon që rreth datës 9 mars t'i rihapë restorantet si pjesë e një kthimi gradual në normalitet, pas disa muajsh në izolim për shkak të pandemisë së Covid-19. Ky vend prin në botë për vaksinimin e popullsisë kundër koronavirusit. Deri më tani 41% e izraelitëve kanë marrë të paktën një dozë të vaksinës. Izraeli ka thënë se do t'i rihapë pjesërisht hotelet dhe palestrat

më 23 shkurt për personat që janë vaksinuar dhe për ata që kanë fituar imunitet pasi janë shëruar nga Covid-19. Për të hyrë në këto objekte, këta persona duhet të paraqesin një dokument përmes një aplikacioni të Ministrisë së Shëndetësisë që tregon dosjen e tyre mjekësore. "Ne po bëjmë plane që ta rihapim vendin gradualisht, por me kujdes që të mos kemi një shpërthim tjetër të

pandemisë", ka thënë për "Ynet TV", Nachman Ash, koordinator kombëtar i përgjigjes ndaj pandemisë. Izraeli filloi të dilte nga bllokimi i tij i tretë të dielën e kaluar. Të hënën ky vend nënshkroi një marrëveshje me Greqinë për t'i lehtësuar kufizimet e udhëtimit atje për izraelitët që kanë dokumentin që janë vaksinuar. Një marrëveshje e tillë është arritur edhe me Qipron.

Tërmet i fuqishëm në Japoni

Tokio, 14 shkurt - Më shumë se 100 persona janë lënduar pas një tërmeti të fuqishëm që goditi brigjet e Fukushima në Japoni. Tërmeti me magnitudë 7.3 të shkallës riterit u ndje edhe në Tokio. Dridhja e tokës vjen thuhet një dekadë pas tërmetit dhe cunamit që i mori jetën më shumë se 18 mijë personave. Ky cunam para një

dekade shkaktoi edhe një aksident bërthamor në impiantin Fukushima Daiichi, incidenti më i rëndë i këtij lloji që nga katastrofa e Çernobilit në vitin 1986. Ky tërmet bëri që thuhet një milion shtëpi të mbeten pa energji elektrike. Shërbimet e trenave janë ndalur ndërkohë që ka pasur dhe rrëshqitje toke.



Itali, moti i acartë mbyll shkollat në disa province

Romë, 14 shkurt - Moti i keq në Itali ka shkakuar ngrica në rrugë, me probleme e aksidente në rajone ku bora ka mbuluar edhe zonat fushore dhe termometri po regjistron nivele nën zero.

Ajri i ftohtë, që vjen nga lindja, i ka ulur temperaturat në -13 deri në -15 gradë celsius. Autoritetet qeveritare kanë urdhëruar mbylljen e shkollave në të gjitha nivelet, si dhe është pezulluar

mësimi në distancë për shkollat e mesme. Sipas ekspertëve, situata pritet të përkeqësohet në orët e ardhshme, me reshje dëbore edhe në lartësi relativisht të ulëta.



Kosova mbajti më 14 shkurt zgjedhjet e parakohshme parlamentare

Vetëvendosje fituese e zgjedhjeve

Në bazë të rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje ka fituar zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit me rreth 48 për qind të votave. Pas LV-së është radhitur e dyta, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me rreth 17 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 13 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.45 për qind, ndërkaq Nisma Socialdemokrate nuk ka arritur ta kalojë pragun zgjedhor prej 5 për qind

"Epoka e re"

Prishtinë, 14 shkurt- Lëvizja Vetëvendosje ka fituar bindshëm zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Në bazë të rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje ka fituar rreth 48 për qind të votave. Edhe koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve në Kosovë, Demokracia në Veprim (DnV), ka dalë me rezultate paraprake të zgjedhjeve të 14 shkurtit, sipas të cilave, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 48.95 për qind të votave.

Po sipas tyre, Partia Demokratike e Kosovës ka fituar 16.93 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës

13.34 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 7.45 për qind, Lista Serbe 4.64 për qind, Nisma Socialdemokrate 2.5 për qind. Kjo e fundit, me këtë rezultat, nuk e kalon pragun zgjedhor.

Ismet Kryeziu, nga Demokracia në Veprim, ka thënë në një konferencë për media se në këto përqindje të prezantuara nuk janë përfshirë votat me kusht e as nga ato nga diaspora.

Pas përfundimit të procesit zgjedhor, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka shpallur fitoren e partisë së tij në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit në Kosovë. "Ky referendum për drejtësi dhe punë, e kundër kapjes së shtetit dhe korrupsionit u fitua. Është diçka e pashembullt në Kosovën e

pasluftës", ka thënë Kurti në një konferencë për media nga selia e partisë së tij në Prishtinë. "Nga nesër fillon një ditë e re. Na presin shumë punë dhe angazhime, sepse vendi është në kriza të shumëfishta", ka thënë ai, duke shtuar se: "Secili prej nesh duhet ta marrë përgjegjësinë që i takon, për ta bërë vendin tonë një vend të jetueshëm për të gjithë, ashtu siç është i dashur për të gjithë", tha po ashtu Kurti, duke u zotuar se Vetëvendosje do të udhëheqë "pa inate dhe pa revanshizëm", ka thënë Kurti.

Vjosa Osmani, kandidate e listës së Vetëvendosjes për presidente, ka theksuar se me fitoren e kësaj partie "Kosova do të ndryshojë". "Institucionet e reja do të drejtohen nga drejtësia", ka deklaruar ajo.




Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, njëherësh kandidati i kësaj partie për kryeministër, e ka uruar Lëvizjen Vetëvendosje për fitoren dhe ka bërë të ditur se partia e tij, nuk do të jetë pjesë e qeverisë. Kandidati për kryeministër i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, tha se merr "përgjegjësinë e plotë" për rezultatit e partisë së tij në zgjedhjet e 14 shkurtit në Kosovë. Në një konferencë për media në Prishtinë, Hoti tha se "rezultatet janë tjera me ato që i kemi pritur".

Lëvizjen Vetëvendosje e ka uruar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Dalja në zgjedhje, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ishte 47 për qind. Zgjedhjet e 14 shkurtit u vlerësuan të qeta, pa asnjë incident.

Vendvotimet u hapën në orën 7:00 dhe u mbyllën në orën 19:00. Qytetarët që ishin brenda qendrave të votimit u lejuan që të votojnë edhe pas orës 19:00.

Të drejtë vote në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit kishin 1.794.862 qytetarë.

Votojnë liderët



Ushtruesja e detyrës e presidentit të vendit, Vjosa Osmani, e cila është pjesë e listës së Lëvizjes Vetëvendosje, pasi ka hedhur votën e saj, ka thënë se sot qytetarët nëpërmjet vullnetit të lirë do ta përcaktojnë të ardhmen e vendit të tyre. Ajo ka falënderuar të gjithë komisionarët dhe vëzhguesit, të cilët do ta mbrojnë dhe vëzhgojnë votën, derisa të numërohet edhe vota e fundit. Gjithashtu, ka falënderuar edhe organizatat joqeveritare vendore dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë të cilët kanë dhënë kontributin e tyre për zgjedhje fer dhe demokratike.



Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kandidat për kryeministër, Albin Kurti, pas votimit në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ka thënë se "e diela është një ditë e bardhë, e ndritshme, ashtu siç do të jetë edhe e ardhmja jonë". "Qytetarët kanë nevojë për demokraci, institucionet kanë nevojë për legjitimitet. Sot kjo nevojë është edhe e drejtë, e cila, më tej, paraqet mundësi e shans që duhet shfrytëzuar dhe duhet përdorur. Kosova si shtet i pavarur këtë të diel i kthehet popullit si burim i sovranitetit", ka thënë Kurti.



Kryetari i PDK-së, njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, i shoqëruar nga bashkëshortja Remzije Shahini-Hoxhaj dhe djali i tyre, kanë votuar në Fakultetin e Filologjisë. Hoxhaj pas votimit ka thënë se qytetarët sot janë para dy opsioneve. "Sot është dita kur flasim qytetarët e jo politikanët. Ata janë para dy opsioneve, para rimëkëmbjes ekonomike apo para një opsioni të mjegullës dhe izolimit të vendit. U dëshiroj suksese të gjithë qytetarëve!", ka deklaruar Hoxhaj. Kandidati për kryeministër nga LDK-ja, Avdullah Hoti, i



shoqëruar nga bashkëshortja, kanë votuar në Fakultetin e Filologjisë. Ai ka thënë se pret që të ketë një proces të rregullt zgjedhor, i cili do ta mbante standardin e rregullave sipas atyre evropiane. Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, së bashku me bashkëshorten kanë votuar në Shkollën e Mesme të Mjekësisë "Ali Sokoli". "E ushtruar të drejtën tonë për të votuar. I lus të gjithë qytetarët që të votojnë. Na presin shumë sfida, si: përballja me Serbinë, situata me pandeminë. Ju lutem votoni të gjithë", ka thënë Haradinaj.



Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, së bashku me bashkëshorten kanë votuar në shkollën "Faik Konica" në kryeqytet. Pas votimit, Limaj shprehet se që këto zgjedhje të prodhojnë stabilitet, siguri dhe një qeverisje të qëndrueshme. "Urime të gjithë qytetarëve të Kosovës ky proces zgjedhor! Shpresoj që këto zgjedhje të prodhojnë stabilitet, siguri dhe qeverisje të qëndrueshme. Të gjitha këto mund të vijnë, nëse vazhdojmë të jemi krenarë për të kaluarën e duke mos e mohuar atë", ka thënë Limaj.

Kosnetti: I takon popullit të Kosovës të vendosë se si do të duket qeveria e re

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka thënë se i takon popullit të Kosovës që të vendosë se si do të duket Qeveria e re e Kosovës. Kosnett ka theksuar se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara që zgjedhjet e parakohshme të 14

shkurtit të jenë të lira dhe të sigurta. "ShBA-ja është e përkushtuar që të shohë zgjedhje të lira, fer dhe të sigurta. Por, nëse dikush ju thotë se ShBA-ja ka ndonjë rezultat të parapëlqyer, kjo thjesht nuk është e vërtetë. Ne jemi të përkushtuar për të parë

zgjedhje të lira, të drejta dhe të sigurta, por vetëm popullit të Kosovës i takon që të vendosë se si do të duket qeveria e re e këtij vendi", ka deklaruar Kosnett për mediat në Prishtinë, pas vizitës që i bëri Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.





FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIK KAMBERI

Qeveria e re ta përfshijë çështjen e Luginës në dialogun me Serbinë

Deputeti shqiptar në parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka bërë me dije se qeveria e re e Kosovës, e cila do të dalë nga zgjedhjet e 14 shkurtit, duhet ta përfshijë çështjen e Luginës në dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kjo është mundësia e fundit për të ndikuar në përmirësimin e pozitës së shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Kamberi ka kritikuar Gjykatën e Lartë në Beograd që ka refuzuar ta shpallë fajtor ministrin Aleksandër Vulin për gjuhën e urrejtjes ndaj shqiptarëve. Sipas tij, ky është një precedent i rrezikshëm i cili e kthen Serbinë në periudhën e Aleksandër Rankoviçit

Ky është një precedent i rrezikshëm, që na kthen në periudhën e Aleksandër Rankoviçit dhe legjitimon e legalizon gjuhën e urrejtjes ndaj komuniteteve në Serbi", është shprehur ai.

Më tej, Kamberi ka treguar se edhe fjalimi i tij në gjuhën shqipe në parlamentin serb ka qenë si shenjë proteste ndaj këtij vendimi. "Vendimi im për t'u shprehur në gjuhën shqipe në Parlament, ishte edhe një formë e shprehjes së rezistencës, ndaj këtij vendimi konkret, por edhe politikës diskriminuese e cila është mohuese ndaj kërkesave dhe të drejtave tona", ka thënë ai, duke treguar për reagimet që ka marrë. "Reagimet u panë në vetë seancën, jo që nuk kishte mirëkuptim, apo ndonjë

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

Prishtinë, 14 shkurt - Deputeti shqiptar në parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka bërë me dije se Qeveria e re Kosovës duhet t'i ketë parasysh kërkesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Ai ka thënë se kjo qeveri duhet ta përfshijë në dialogun me Serbinë çështjen e

Luginës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Kamberi ka thënë se kjo është mundësia e fundit për përmirësimin e të drejtave të shqiptarëve të asaj pjese. "Ajo që në vazhdimësi po e kërkojmë: që çështja e Luginës së Preshevës të përfshihet në dialogun me Beogradin, si mundësia e fundit për të ndikuar në përmirësimin e pozitës së shqiptarëve, duke

kërkuar respektimin e parimit të reciprocitetit në respektimin unik dhe reciprok të të drejtave të komuniteteve", ka deklaruar Kamberi. Ai e ka kritikuar vendimin e Gjykatës së Lartë në Beograd që ka refuzuar ta shpallë fajtor ministrin Aleksandër Vulin për diskriminim, fyerje dhe gjuhë të urrejtjes ndaj shqiptarëve.

Kamberi ka thënë se kjo është

një precedent i rrezikshëm, i cili e kthen Serbinë në periudhën e Aleksandër Rankoviçit. "Kjo paraqet dëshmi për ndikimin politik në sistemin e gjyqësorit. Ato tregojnë se partia në pushtet në Serbi ka kapur gjitha institucionet, prandaj edhe ky vendim i Gjykatës së Lartë, ndaj padisë së Këshillit Kombëtar, paraqet ndërhyrje të vrazhdë të politikës në sistemin e drejtësisë.



urrejtjes ndaj komuniteteve në Serbi.

“Epoka e re”: Më pas ju mbajtët një fjalim në gjuhën shqipe në parlamentin e Serbisë. Pse ndodhi kjo dhe a kishte ndonjë reagim ndaj jush, meqenëse për herë të parë pas luftës dikush po mbante fjalim në gjuhën shqipe në këtë institucion?

Kamberi: Vendimi im për t’u shprehur në gjuhën shqipe në parlament ishte edhe një formë e shprehjes së rezistencës, ndaj këtij vendimi konkret, por edhe politikës diskriminuese e cila është mohuese ndaj kërkesave dhe të drejtave tona. Reagimet u panë në vetë seancën, jo që nuk kishte mirëkuptim apo ndonjë shprehje keqardhje ndaj toneve raciste të A. Vulin, aq më tepër nga radhët e deputetëve të SNS u tentua që përmes ndërhyrjeve të më pengojnë në mbajtjen e fjalimit. Por, agresiviteti i shprehur i tyre vetëm më ka inkurajuar edhe më tepër për ta përfunduar fjalimin tim.

“Epoka e re”: Qeveria e re e Serbisë tashmë ka kaluar 100-ditëshin e punës. Çfarë ka treguar për këto periudhë kjo qeveri?

Kamberi: Asgjë konkrete. Vetë fakti që qeveria Brnabiq 2 nuk ka prezantuar në parlament për 100 ditët e para është dëshmi të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzion se rezultatet e saj, në shumë sfera, sidomos rreth procesit të integritimit në BE dhe përmbushej së obligimeve që sjellin kapitujt integrujes, janë tejet modeste.

“Epoka e re”: Zgjedhjet e parakohshme në Kosovë u mbajtën më 14 shkurt dhe kësaj radhe në lisat zgjedhore të partive ka pasur edhe kandidatë nga Lugina e Preshevës. Si e keni parë këtë hap të partive politike në Kosovë?

Kamberi: Po, është për ta përshëndetur entuziazmin që partitë politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet e 14 shkurtit, po e tregojnë rreth Luginës së Preshevës, qoftë edhe përmes përfshirjes në listat e tyre kandidatë me prejardhje nga Lugina. Mbetet për të dëshiruar që këto premtime të bëhen edhe program qeverisës i qeverisë së re në Prishtinë.

“Epoka e re”: Siç dihet, një ndër sfidat kryesore të qeverisë që do të dalë pas zgjedhjeve do të jetë dialogu me Serbinë. Çfarë duhet të bëjë qeveria e re për shqiptarët e Luginës në këtë proces?

Kamberi: Ajo që në vazhdimësi po e kërkojmë: që çështja e Luginës së Preshevës të përfshihet në dialogun me Beogradin, si mundësia e fundit për të ndikuar në përmirësimin e pozitës së shqiptarëve, duke kërkuar respektimin e parimit të reciprocitetit në respektimin unik e reciprok të të drejtave të komuniteteve.

Milaim Zeka thotë se formimi i qeverisë është në pikëpyetje

Prishtinë, 14 shkurt - Analisti Milaim Zeka ka qenë i ftuar në emisionin “Top Talk” në “Top Channel”. Aty ka folur rreth zgjedhjeve në Kosovë. Ai ka thënë se fitorja e Lëvizjes Vetëvendosje nuk do të jetë ashtu siç pretendon lideri i saj, Albin Kurti. “Fitorja nuk do të jetë ashtu siç pretendojnë Albin Kurti dhe Vjosa Osmani. Fitorja nuk do të jetë as sipas sondazheve. Vetëvendosja do të fitojë 40 për qind, maksimumi 41 për qind të votave, që përkon ndoshta me 45-46 mandate”, ka thënë Zeka. Sipas tij, problemi kryesor është posti i presidentit, sepse nëse nuk zgjedhet presidenti, vendi do të shkojë sërish në zgjedhje. “Janë dy probleme. Në rastin konkret, formimi i qeverisë është problem dytësor. Problemi kryesor është presidenti. Moszgjdhja e presidentit neve na çon automatikisht në zgjedhje të reja. Do të kemi zgjedhje

prapë. Se kur, nuk e di, brenda disa muajve apo brenda muajit tetor, varet nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese”, ka deklaruar ai.

Zeka e arsyeton jologjik caktimi e Albin Kurtit kryeministër, pasi i është ndaluar nga Gjykata Kushtetuese të garojë për deputet, për shkak të përfshirjes në hetimet për krime lufte. “A ka mundësi të jetë kryeministër i vendit një person të cilët i është ndaluar kandidatura për deputet. Nuk është logjike. Me këtë njollë që ka kryeministri i ardhshëm i Kosovës dhe është ndaluar nga Gjykata Kushtetuese, cilët politikanë perëndimorë do të pranojnë të ulen me të”, thotë ai.

Zeka ka pohuar se duhet bashkëpunim me ambasadat që një qeveri e Kosovës të sigurojë qëndrueshmëri. “Vetëm ndërhyrja e ambasadës së ShBA-së dhe të tjera, nëse bëjnë presion dhe

nxjerrin një president/e të ri. Njëra nga kandidatet mund të jetë ambasadorja jonë në ShBA, Vlora Çitaku ose ish-ambasadori në ShBA, Avni Spahiu. Qeveritë në Kosovë nuk mund të mbijetojnë pa një bashkërendim me ambasadat. Nëse Albin Kurti nuk i bindet Uashingtonit dhe Brukselit për dialogun me Serbinë, sërish do të rrëzohet”, është shprehur Zeka.

Ndër të tjera, ai e ka akuzuar Lëvizjen Vetëvendosje se ka pranuar kandidatë të përfshirë në korrupsion dhe jo vetëm: “Vetëvendosje është një parti që e ka hapur thesin për çdo kënd, për ekstremistët fetarë. Ka kandidat për deputet që ka deklaruar publikisht se Izraeli duhet të zhduket nga faqja e dheut”, është shprehur ai. Sipas analistit Zeka, pas zgjedhjeve të 14 shkurtit do të kemi fitoren e Vetëvendosjes dhe negociata të gjata të Albin Kurtit për t’u bërë kryeministër.



shprehje keqardhje ndaj toneve raciste të A. Vulin, aq më tepër, nga radhët e deputetëve të SNS u tentua që përmes ndërhyrjeve të më pengojnë në mbajtjen e fjalimit. Por, agresiviteti i shprehur i tyre vetëm më ka inkurajuar edhe më tepër për ta përfunduar fjalimin tim”, është shprehur Kamberi.

“Epoka e re”: Z. Kamberi, Gjykata e Lartë në Beograd ka refuzuar ta shpallë fajtor ministrin Aleksandër Vulin për diskriminim, fyerje dhe gjuhë të urrejtjes ndaj shqiptarëve. Si e keni parë këtë vendim të gjykatës?

Kamberi: Kjo paraqet dëshmi për ndikimin politik në sistemin e gjyqësorit. Ato tregojnë se partia në pushtet në Serbi, ka kapur të gjitha institucionet, prandaj edhe ky vendim i Gjykatës së Lartë, ndaj padisë së Këshillit Kombëtar, paraqet ndërhyrje të vrazhdë të politikës në sistemin e drejtësisë. Ky është një precedent i rrezikshëm, që na kthen në periudhën e Aleksandër Rankoviçit dhe legjitimon e legalizon gjuhën e

Çfarë duhet të dini për vaksinën e 'AstraZenecas' të cilën e pret Kosova?



Prishtinë, 14 shkurt - Vaksinën e "AstraZenecas" dhe Oksfordit kundër koronavirusit, Kosova pritet ta marrë falas përmes programit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, COVAX, që ka për qëllim të shpërndajë vakcina në vende të varfra. Sipas një raporti të publikuar më herët gjatë këtij muaji, Kosova do të marrë nga COVAX-i 100 800 doza të kësaj vaccine. Më herët, nga zyra e OBSH-së në Prishtinë kanë thënë për Radion Evropa e Lirë se dozat e para nga COVAX-i do të arrijnë në Kosovë në mesin e muajit shkurt apo në javën e tretë.

Vaksina e "Oxford/AstraZeneca" ka 63.9 për qind efikasitet kundër sëmundjes Covid-19, sipas analizave preliminare, thotë Organizata Botërore e Shëndetësisë, e cila ka rekomanduar që kjo vaksinë të përdoret. Kjo vaksinë administrohet me dy doza. OBSH-ja thotë se vakcina shfaq më shumë efikasitet kur intervali kohor nga doza e parë te doza e dytë është më i gjatë. "Kjo, së bashku me gjetjen e niveleve më të larta të antitropave kur rritet intervali në mes të administrimit të dy dozave, mbështet përfundimin se intervalet më të gjata ndërmjet dozave brenda intervalit 4-12 javë shoqërohen me efikasitet më të madh të vaksinës. Për shkak të këtyre gjetjeve, sa i përket efikasitetit të dy dozave dhe rritjes së imunitetit kur doza e parë dhe doza e dytë kanë interval më të gjatë kohor, OBSH-ja rekomandon që dozat të merren

ndërmjet intervalit 8-12 javë", thotë OBSH-ja. Vaksina e Universitetit të Oksfordit dhe kompanisë farmaceutike britanike "AstraZeneca" rekomandohet të merret nga moshë 18 vjeçe dhe sipër.

Sa i përket mundësisë që kjo vaksinë të përzihet me vakcina të tjera, pra një person të mund të marrë një dozë të "AstraZenecas" dhe dozën tjetër të ndonjë vaccine tjetër të zbuluar, OBSH-ja rekomandon që të mos bëhet një gjë e tillë dhe personat t'i marrin dy dozat e vaksinës nga i njëjti prodhues.

Sa i përket mundësisë së reaksioneve alergjike ndaj vaksinës, rekomandohet që nëse një person, pas marrjes së dozës së parë ka reaksione alergjike, të mos e marrë dozën e dytë të së njëjtës vaksinë.

Megjithatë, gjatë studimeve klinike shkencëtarët thuhet se nuk kanë vërejtur që kjo vaksinë ka shkaktuar reaksione alergjike. "Megjithatë, si të gjitha vaksinat, edhe vakcina e 'AstraZenecas' duhet të administrohet nën mbikëqyrjen e punëtorëve shëndetësorë, të cilët mund ta japin trajtimin e duhur mjekësor nëse shfaqen reaksione alergjike", thotë OBSH-ja, duke shtuar se si për çdo vaksinë tjetër, duhet që për 15 minuta të vëzhgohet personi që ka marrë vaksinën për ndonjë reaksion të mundshëm.

Vaksina dhe personat mbi 65 vjeç

Për shkak të numrit të vogël të pjesëmarrësve të moshës 65

vjeç apo më të moshuar, në provat klinike të kësaj vaccine, vlerësimi i efikasitetit të kësaj vaccine ndaj kësaj grupmoshe është i gjerë. "Vlerësime më të sakta për efikasitetin për këtë grupmoshë pritet së shpejti, si nga provat që po zhvillohen, por edhe nga studimet mbi efikasitetin që po bëjnë shtetet që po e përdorin këtë vaksinë. Përgjigjet imunitare që janë shkaktuar nga vakcina te personat e moshuar janë të dokumentuara mirë dhe janë të ngjashme si te grupmoshat e tjera. Kjo sugjeron që ka shumë gjasa që vakcina të jetë efektive edhe te personat e moshuar. Të dhënat e provave thonë se vakcina është e sigurt për këtë grupmoshë", thuhet në vlerësimin e OBSH-së. Për shkak se personat 65 vjeç dhe më të moshuar nuk janë përfshirë në provat klinike, disa shtete, përfshirë edhe Gjermaninë, kanë rekomanduar që atyre të mos u administrohet vakcina e "AstraZenecas".

Personat nën 18 vjeç

Deri më tani nuk ka të dhëna lidhur me efikasitetin dhe sigurinë që kjo vaksinë të përdoret te fëmijët apo adoleshentët nën moshën 18-vjeçare. "Derisa të ketë të dhëna për këtë grupmoshë, vaksinimi i personave nën 18 vjeç nuk rekomandohet", vlerëson OBSH-ja. Ndërkaq, sa iu përket grave shtatzëna dhe atyre që ushqejnë fëmijët e tyre me gjii, thuhet se ato janë në

rrezik të madh që të sëmuren rëndë nga Covid-19 krahasuar me gratë që nuk janë shtatzëna. Po ashtu, Covid-19 është shoqëruar me rrezikun e lartë të lindjeve të parakohshme. "Të dhënat aktuale mbi vaksinimin e grave shtatzëna me 'AstraZeneca' janë të pamjaftueshme për ta vlerësuar efikasitetin apo rreziqet që lidhen me vaksinimin gjatë shtatzënisë", thotë OBSH-ja, duke shtuar se ngjashëm janë të dhënat edhe për gratë gjdhënëse dhe nuk dihet nëse vakcina ndikon te qumështi.

Megjithatë, OBSH-ja thekson se vakcina e "AstraZenecas" është vaksinë që nuk shumëzohet, andaj thotë se me gjasë nuk paraqet rrezik te fëmijët që ushqehen me gjii. "Marrë parasysh këto, gratë gjdhënëse bëjnë pjesë në grupin që rekomandohet të vaksinohen. OBSH-ja nuk rekomandon ndërprerjen e ushqyerjes me gjii të fëmijëve, pasi nënat të vaksinohen", thuhet në rekomandim. Sa iu përket personave që janë me HIV, ata nuk kanë qenë të përfshirë në analizat preliminare të studimeve mbi efikasitetin dhe sigurinë e kësaj vaccine, andaj të dhënat për këtë grup shoqëror ende nuk janë të qasshme.

Personat që e kanë kaluar Covid-19

Vaksinimi rekomandohet pavarësisht nëse një person e ka kaluar koronavirusin e ri.

Por, personat që janë të konfirmuar si Covid-19 pozitivë, përfshirë ata që janë konfirmuar pozitivë pasi kanë marrë dozën e parë të vaksinës, nuk duhet të vaksinohen, pra të marrin dozën e dytë, derisa ta jenë shëruar nga sëmundja akute.

"Personat që janë të konfirmuar me Covid-19 mund ta shtyjnë vaksinimin deri në gjashtë muaj", rekomandon OBSH.

Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se variantet e reja të koronavirusit janë ende nën vlerësim. Disa variante të reja besohet se janë më ngjitëse, shkaktojnë sëmundje më të rëndë, ka rrezik më të lartë të riinfektimit apo shkaktojnë ndryshim në përbërjen antigjentike, duke rezultuar në efikasitet më të ulët të vaksinës. Sipas të dhënave paraprake, sipas OBSH-së, vakcina "AstraZeneca" është më pak efektive ndaj variantit të shfaqur në Mbretëri të Bashkuar, që shoqërohet me uljen e prodhimit të antitropave. Ndërkaq, analizat e bëra për variantin e Afrikës së Jugut tregojnë se vakcina e "AstraZenecas" është më pak efektive ndaj sëmundjes së moderuar dhe të butë dhe, po ashtu, është vërejtur edhe rënia e antitropave.

Për dallim nga vaksinat e kompanive "Pfizer/BioNTech" dhe "Moderna", që kërkojnë të ruhen në temperatura ultra të ulëta, vakcina e "AstraZenecas" mund të ruhet në frigoriferë normal në temperaturë prej 2 deri në 8 gradë celsius.

Nga 3 031 testime, 246 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 14 shkurt - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 3 031 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 246 raste pozitive.

Brenda 24 orëve nuk janë raportuar raste të të vdekurve. Numri total i rasteve pozitive

është 64 341 raste nga 266 585 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 544 raste të të vdekurve.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 201 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 55 761 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 7 036.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 95 raste, Pejë 24 raste, Gjakovë 17 raste, Lipjan 13 raste, Podujevë 12 raste, Fushë-Kosovë 10 raste, Mitrovicë 10 raste, Gjilan 9 raste, Prizren 8 raste, Malishevë 6 raste, Rahovec 6 raste, Suharekë 5 raste, Skenderaj 4

raste, Vushtrri 4 raste, Deçan 3 raste, Istog 3 raste, Kamenicë 3 raste, Klinë 3 raste, Obiliq 3 raste, Drenas 2 raste, Graçanicë 2 raste, Viti 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Dragash dhe Ferizaj.

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka përgëzuar për punën e palodhshme Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Ai ka thënë se kjo situatë e kontrolluar epidemiologjike është arritur falë bashkëpunimit të të gjithëve. Ministri Zemaj u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë rekomandimet anti-Covid.

Krasniqi: Mund të pritët rritje e rasteve me Covid-19

Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Valbon Krasniqi, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se nëse merren parasysh ngjarjet që kanë ndodhur së fundmi në Kosovë, përfshirë rikthimin e nxënësve në shkolla, pastaj fushatat e partive politike dhe tubimet në masë, në javët në vazhdim mund të pritët rritje e rasteve me Covid-19.

Krasniqi nuk ka dashur ta komentojë lehtësimin e masave kundër Covid-19 nga Qeveria në detyrë e Kosovës, por ka thënë se aktualisht situata me koronavirus është më e mirë sesa muajt e kaluar dhe se numri prej rreth 500 pacientëve të hospitalizuar është nën kontroll. Ai në këtë intervistë ka folur për variantin e ri britanik si dhe për përgatitjet që kanë bërë për vaksinim.



Shefi i BE-së: Jemi këtu për ta mbështetur Kosovën në përpjekjet e saj

Prishtinë, 14 shkurt - Shefi i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se kur ka filluar punën në Kosovë në shtator të vitit të kaluar, ka vërejtur që Kosova ka shumë potencial sa i përket zhvillimit ekonomik. Ai në një intervistë dhënë për gazetaren Majlinda Aliu, ka theksuar se nëse do të bëheshin politika të duhura, Kosova do të mund bëhej ekonomi konkurrense, do ta përmirësonte kualifikimin e forcës punëtore dhe do ta forconte administratën publike. "Kjo do të kishte ndikim të madh për Kosovën

në avancimin e rrugës evropiane. Kosova si përpjekje të menjëhershme për vitin 2021 duhet të ketë arritjen e stabilitetit politik si një faktor kyç për tërheqje të investitorëve, gjithashtu duhet vendosur përpara një agjendë reformuese", ka thënë Tomas.

Ai ka thënë se interesi strategjik afatgjatë i Kosovës në procesin e reformave duhet të jetë në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit si dhe me dokumentin e sapo miratuar "European Reform Agenda 2" (Agjenda për Reformë

Evropiane 2.) "Ambicia jonë e përbashkët për vitin 2021 duhet të mbetet mbështetja afatgjatë e rimëkëmbjes socioekonomike të Kosovës si dhe konvergenca ekonomike me BE-në. Duhet thënë se ka një hendek masiv në aspektin ekonomik mes këtij rajoni dhe BE-së. Sa më shpejt që mbyllim këtë hendek aq më shpejt Kosova do të bëhej ekonomi e fortë dhe e qëndrueshme. BE-ja është këtu për ta mbështetur Kosovën në përpjekjet e saj, me qëllim që të sjellë ndryshime reale dhe të shënojë përparim të



prekshëm, përfshirë rritjen e bizneseve dhe shumë mundësi punësimi për popullatën e Kosovës", ka deklaruar shefi i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog.

Hidrocentralet, problem



Prishtinë, 14 shkurt - Ka disa vjet prej se Arian Krasniqi organizon aktivitete me turistë në shtratin e lumit Drini i Bardhë në Prizren. Ariani është pjesë e Klubit të Kajakut "Lumëbardhi" dhe përmes këtij klubi, gjatë gjithë vitit organizon shëtitje me kajak nëpër shtratin e lumit Drini i Bardhë.

Në fillim të muajit shkurt Ariani është çuditur kur në uebfaqen e Komunës së

Prizrenit pa të publikuar një njoftim për një debat publik për mundësinë e ndërtimit të një hidrocentrali në shtratin e këtij lumi. "Lajmërimin për dëgjim publik, të them të drejtën, e kemi parë me një rezervë dhe një brengë sepse po shohim edhe në regjion, edhe në Kosovë ka shumë telashe me këto projekte që bëhen me hidrocentrale. Shohim raste kur kompanitë nuk po i zbatojnë kushtet e kontratës të cilat i

kanë dhënë dhe krijohen pastaj probleme më të mëdha", ka thënë Krasniqi për "Radion Evropa e Lirë".

Ai thotë se një prej shqetësimeve kryesore të qytetarëve të Prizrenit është fakti se dëgjimi publik për këtë projekt është lënë në një kohë kur Kosova është në fazë të ndërrimit të pushtetit. Kjo, sipas tij, e largon vëmendjen nga ky projekt që parashihet të ndërtohet në lumin më të madh

të Kosovës. "Sa dimë ne dhe sa kemi parë e sa kemi shfletuar, kjo është një digë e madhe dhe në konsultat tona që kemi pasur me njohës të fushës, na kanë thënë se nga aspekti mjedisor kjo është diçka për t'u shqetësuar", është shprehur Krasniqi.

Më 4 shkurt Komuna e Prizrenit njoftoi se do të mbahet Debat i Publik për Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për ndërtimin e hidrocentralit

"EcoDri" në lumin Drini i Bardhë. Debatit do të organizohet në fshatin Dobrushtë dhe të pranishëm do të jenë edhe përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Çfarë parasheh projekti i hidrocentralit "EcoDri"?

Në bazë të dokumenteve të publikuara nga Ministria e

Vlera e Bitcoinit, afër nivelit prej 50 mijë dollarëve

Prishtinë, 14 shkurt - Bitcoin e kishte filluar vitin 2021 me një rritje të fortë, por vlera e tij nuk kishte qenë e qëndrueshme pasi pati një rënie të theksuar. Mirëpo, kjo kriptovalutë ka filluar ta marrë veten. Sipas CoinMarketCap, Bitcoin po tregtohet me rreth 49 100 dollarë, që është shumë afër thyerjes së kufirit prej 50 mijë dollarësh. Të dhënat tregojnë se Bitcoin brenda një jave

kishte rritje prej 30-përqindësh, ndërsa brenda 24-orëve u vlerësua me rreth 5 për qind. Ditë më parë gjiganti amerikan i veturave elektronike "Tesla" ka investuar 1.5 miliard dollarë në vlerë të Bitcoinit, ku planifikon ta pranojë kriptovalutën si mjet pagese. Çmimi i kësaj valute është rritur më shumë se 700 për qind që nga përhapja e pandemisë Covid-19 për herë

të parë në muajin mars 2020. Rritja e kërkesës nga investitorët për kriptovalutën ka nxitur rritjen e vlerës së Bitcoinit në fillim të vitit 2021. Kërkesa u rrit nga mundësia e fitimeve më të shpejta në një botë që aktualisht dominohet me normat negative të interesit. Aktualisht vlera e tregut e kësaj valute është 1.5 trilion dollarë, ku përbën mbi 60 për qind të tregut të katër valutave.



i madh i Kosovës



Ekonomisë dhe Ambientit, hidrocentrali 'EcoDri' do të jetë e tipit digë. Diga pritet të ndërtohet në pjesën e ngushtë të lumit, shumë afër fshatit Dobrushtë.

Në Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për hidrocentralin "EcoDri", thuhet se zbatimi i projektit nuk do të ketë pasojë negative të mëdha në mjedisin e zonës. "I tërë projekti është në përputhshmëri me strategjinë

e zhvillimit energjetik të Republikës së Kosovës dhe është ekologjik, në përputhje me tendencat e zhvillimit të energjetikës alternative në Kosovë", thuhet në raport. "Radio Evropa e Lirë" ka provuar që të flasë me përfaqësuesit e kompanisë "EcoDri", por numri i publikuar në uebfaqen e Agjencisë për Regjistrimit të Bizneseve nuk ka qenë i qasshëm. Edhe kontakti me

kryetarin e Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka qenë i pamundur. Në qershor të vitit 2019 kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, kishte lëshuar një reagim kundër iniciativës për ndërtimin e hidrocentraleve në këtë qytet. "Hidrocentralet, ashtu siç janë të planifikuara, nuk përfshihen në planet zhvillimore të Kosovës, e as në strategjitë dhe planet zhvillimore dhe urbanistike të

Komunës së Prizrenit, si dhe rrezikojnë zhvillimin e bujqësisë dhe të turizmit, të cilat janë prioritetet komunale për zhvillimin e rajonit", thuhet në reagimin që është ende i publikuar në profilin e "Facebook"-ut të kryetarit të Prizrenit, Mytaher Haskuka.

Ambientalistët s'i bind vlerësimi

Ardian Nrecaj, aktivist i Grupit për Mbrojtjen e Ujërave dhe Mjedisit, thotë se duhet marrë me dyshim konstatimet e raportit të vlerësimit për projektin e ndërtimit të këtij hidrocentrali. Ai thotë se ekziston rrezik i madh nga degradimi i ambientit, pikërisht për faktin se për këtë hidrocentral parashihet të ndërtohet një digë në shtratin e lumit Drini i Bardhë. "Është absurde të thuhet se nuk do të ketë ndikim në mjedis. Një lopatë ta marrësh dhe ta vendosësh në një vend tjetër ndikon në mjedis dhe lëre më të futësh beton në rrjedhën ekologjike të një lumi. Ne jemi duke lexuar raportin dhe do të dalim me rekomandimet tona dhe do të kërkojmë përgjegjësi", ka pohuar Nrecaj, duke shtuar se ndërtimi i këtij hidrocentrali me digë do të ketë efekte të mëdha negative si në dëmtimin e biodiversitetit, po ashtu edhe në turizmin e asaj zone.

Përvojat e këqija të Deçanit dhe të Shtërpçës

Në rrjedhën e lumit kryesor në grykën e Deçanit janë të ndërtuara katër hidrocentrale. Ndërtimi dhe vënia në funksion e këtyre hidrocentraleve ishte përcjellë me mungesë transparence dhe kundërshtim qytetar. Adem Lushaj, aktivist nga Deçani, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se çdo iniciativë për ndërtimin e hidrocentraleve në Kosovë duhet përcjellë me

kujdes të shtuar ndryshe, sipas tij, do t'i shkaktohen dëme të pariparueshme ambientit. "Investimi që ka ndodhur në Komunën e Deçanit është shembulli më i mirë se si nuk duhet lejuar të ndërtohen edhe në komunat e tjera hidrocentralet sikurse janë ndërtuar në Deçan. Gjatë sezonit të verës ka ndodhur të mos jetë pika e ujit nëpër shtratin e lumit, që do të thotë nuk ndodh as respektimi i minimumit ekologjik, që është direktivë e Bashkimit Evropian" thotë Lushaj. Më 12 shkurt 2021 Gjykata Themelore e Prishtinës ka vendosur për shtyrjen e ekzekutimit të lejeve për tri hidrocentrale që janë të ndërtuara në Grykën e Deçanit.

Getoar Mjeku, në cilësinë e përfaqësuesve të personave që kanë paditur kompaninë "Kelkos Energy" për mosrespektim të ligjit, ka thënë, në një njoftim, se "shtyrja e ekzekutimit vendoset për ta parandaluar dëmin e pariparueshëm deri kur të shqyrtohet padia jonë kundër dy organeve vendimmarrëse, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë".

Një iniciativë për ndërtimin e hidrocentraleve, para dy vjetësh, ishte edhe në qytetin e Pejës, mirëpo kundërshtimi i madh qytetar dhe i autoriteteve komunale bëri që iniciativa të parandalohet. Për disa vjet rresht kanë protestuar kundër hidrocentraleve edhe banorët e Shtërpçës. Më të zëshmit kanë qenë banorët e fshatit Biti e Poshtme, të cilët kanë kundërshtuar futjen e lumit Lepenc në gypa.

Përkundër protestave dhe reagimeve të shumta të organizatave të shoqërisë civile, punimet nuk u ndalën dhe hidrocentralet në këtë rrjedhë janë afër përfundimit. Rreth 95 për qind energjisë elektrike në Kosovë prodhohet nga thëngjilli, ndërsa vetëm 2.7 për qind nga hidrocentralet.

Guvernatori i BQK-së: Qeveria e ardhshme fokus duhet ta ketë ekonominë

Prishtinë, 14 shkurt - Qeveria e re e cila pritet të formohet pas zgjedhjeve të nesërme duhet të ketë në fokus ekonominë, veçanërisht adresimin e sfidave që i ka Kosova ndër vite, papunësinë, deficitin tregtar dhe sanimin e dëmeve ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Këto sugjerime për ekzekutivin e ri i ka adresuar guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK),

Fehmi Mehmeti, i cili thotë se sektori bankar ka pasur dhe vazhdon ta ketë rolin e saj në rimëkëmbjen ekonomike. Guvernatori Mehmeti në një intervistë për "KosovaPress" ka thënë se BQK-ja pret që për vitin 2021 vendi të ketë një rritje ekonomike prej 4-përqindësh, gjithnjë nëse situata me pandeminë shkon drejt përmirësimit. "Sugjerimet tona si Bankë Qendrore, janë që qeveria e

ardhshme fokus duhet ta ketë ekonominë, me qëllim që të kemi një rritje sa më të madhe ekonomike. Një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe njëkohësisht një rritje e cila, përpos që adreson sfidat që i ka pasur ndër vite Kosova, që është papunësia, deficit i lartë tregtar, njëkohësisht i sanon edhe dëmet ekonomike të shkaktuara nga pandemia", ka thënë Mehmeti.



Komuna e Prizrenit u rri gati rrugëve

PRIZREN, 14 SHKURT (ER) - Pas reshjeve të borës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, nëpërmjet kompanive të kontraktuara, ka vazhduar angazhimin për pastrimin e rrugëve dhe hedhjen e kripës nëpër rrugë të lagjeve të fshatrave të komunës së Prizrenit. "Kompanitë do ta vazhdojnë punën e tyre sipas planeve operative në terren, ndërkaj vlen të theksohet se në rajonin Zhupës temperaturat kanë

arritur deri në -15 gradë celsius, e për këtë arsye hedhja e kripës në disa pjesë të këtij rajoni mund të mos tregojë rezultate të shpejta", është thënë në njoftimin e komunës së Prizrenit. Kjo komunë ka theksuar se do ta vazhdojë angazhimin për lehtësimin e qarkullimit, ndërkaj ka ftuar të qytetarët që të kenë kujdes të shtuar, sidomos gjatë drejtimit të automjeteve të tyre.



Arkivi Historik i Podujevës zhvendoset në ish-objektin e komunës



PODUJEVË, 14 SHKURT (ER) - Komuna e Podujevës ka njoftuar se nga 15 shkurti Arkivi Historik do të zhvendoset në ish-objektin e komunës. Të

gjitha shërbimet e arkivit, të cilat deri më tani janë ofruar në objektin e deritashëm, tani e tutje qytetarët do ta kenë mundësinë t'i marrin në

këtë objekt. Zhvendosja e arkivit është bërë për shkak të kushteve më të mira infrastrukturore që ofron ish-objekti i administratës komunale.

QKMF-ja në Gjakovë furnizohet me 5 000 teste rapide

Gjakovë, 14 shkurt (ER) - Me qëllim të parandalimit të përhapjes së Covid-19, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë janë dorëzuar 5 000 teste rapide, donacion ky nga Ministria e Shëndetësisë. Këto teste do të jenë në shërbim të

komisionarëve dhe vëzhguesve të cilët janë të angazhuar për mbikëqyrjen e zgjedhjeve të parakohshme në Republikën e Kosovës. Në ditët në vijim, një sasi e testeve rapide do të jenë edhe në shërbim të qytetarëve të tjerë.



Rrugët në Mitrovicë zhblllokohen nga bora

Mitrovicë, 14 shkurt (ER) - Ndonëse në tërë qytetin e Mitrovicës, në veçanti në rajonin e Shalës së Bajgorës po mbretëron acar i vërtetë, kompanitë e kontraktuara nga komuna janë të angazhuara pandërprerë në zhbllokimin e të gjitha rrugëve nga bora. Me rastin e zhbllokimit të rrugëve nga bora ishte i pranishëm edhe drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, i cili ka inspektuar të gjitha rrugët në qytet, në lagje dhe fshatra të Mitrovicës. Drejtori Muja ka potencuar se bora që ka rënë këto dy ditë dhe era e fortë në disa vende e ka bërë më të vështirë qarkullimin e automjeteve dhe të njerëzve. Megjithatë, ai thekson se kanë qenë në



gatishmëri dhe, falë angazhimit të shtuar edhe nga kompanitë e kontraktuara, tani

rrugët në fshatra dhe në qytetin e Mitrovicës janë bërë të kalueshme. Gjithashtu, drejtori

Muja ka bërë apel te të gjithë qytetarët t'i përdorin pajisjet dimërore dhe të kenë kujdes të

shtuar gjatë vozitjes si dhe ta shmangin qarkullimin përreth zonave malore.

Zgjedhjet në Shqipëri, kambanat po bien me të madhe



Nga Bedri ISLAMI

Në marsin e vitit 1991 bëheshin zgjedhjet e para pluraliste, më saktë prova e parë për zgjedhje të tilla. Kishte fituar Partia e Punës dhe më 1 prill, kur po dërgoja tim bir në kopsht, gjeta kujdestaren e përlotur dhe me një trishtim epik. E njihja, se me vëllanë e saj ishim miq. Mendova se kishte ndodhur diçka. Duke qarë më tha se kishin humbur shansin e jetës, se në portet e Italisë dhe të Spanjës ishin ankoruar me mijëra anije të mëdha me ndihma për Shqipërinë, nëse do të fitonte opozita që, për rastësi, edhe sot është opozitë. E kisha dëgjuar si bisedë, por nuk mendoja se kishte njerëz normalë që e besonin këtë çmenduri. E, megjithatë, ajo qante me ngulm. Luga e floririt, që u ishte premtuar, kishte humbur. Më pas erdhi çeku i bardhë, ne drejtojmë, bota na ndihmon, fantazitë surrealiste dhe tani, pas tri dekadave, jemi ende me të njëjtën fushatë banale. Të vjen të mendosh: këta liderë politikë na mendojnë të tredhur në tru? Megjithëse “de jure” fushata e zgjedhjeve parlamentare, 25 prill 2021, ende nuk ka filluar, faktikisht ajo po zhvillohet çdo ditë, kudo që është e mundur dhe me të gjithë makineritë e ndezura. Është fillimi i saj dhe, megjithatë, vala e premtimeve,

publikimet, promovimet, videot, konferencat, takimet, përrurimet, çelësat, krushqitë, meritë, memet, deklaratat, sajimet, përplasjet, llogaritë, “burrëritë”, kërcënimet, ndarjet e takimet janë bërë aq përditshmëri, saqë edhe mendimi se çfarë do të mund të ndodhë në ditët e mëpasshme, të lodhë, të ngujon, të bën apatik dhe të krijon një gjendje rëndese që është e vështirë të bartet.

Secili nga liderët po përpigjet të sjellë te njerëzit figurën e atij që është i përgjyruar për popullin; vetëm të presim disa ditë, ja, edhe pak javë dhe çdo gjë do të rrjedhë nga çezmat si asnjëherë tjetër.

Sikur të mos i kishim njohur e, për më tepër, sikur të mos i kishim provuar, mund të ishim gënijer. Sikur të mos e dinim se cilët ishin, do të na ishte falur të mendonim se prej tyre dhe vetëm prej tyre, do të mund të ishim njerëz të lumtur, komb i qytetëruar, i denjë për një jetë normale. Sikur të ishim rishtarë në jetën plurale do të mund të mendonim se këta “burra e gra” që shfaqen para nesh janë të një race tjetër, një lloj tjetër, që nuk kishim pasur fatin t’i njohim më parë dhe se këto dhe vetëm këto kishte pritur ky vend.

Por, ne i njohim. I njohim të gjithë. I kemi provuar të gjithë. Që nga presidenti i vendit që sot mbyllet në skuta dhe shkel të gjitha nenet e Kushtetutës, ku është dërguar si gardian i saj, te kryeministri që tash tetë vjet sillet e sillet e bie në kunj e nuk lidhet, te shefi i opozitës, i mbuluar në mëkatet e tij, te shefja e opozitës që i takon të

jetë edhe gruaja e parë e shtetit, por që shtetin, kur ishte familje kryeministore, e bëri rrumpallë, pra të gjithë.

Të tjerët janë bishta që sillen rreth e rrotull dhe duan të përllajnë një copë për vete. As nuk i ka rënë ndonjëherë në mend për Shqipërinë dhe as nuk i bie ndërmend as sot e kësaj dite.

Video të shumta po qarkullojnë në tregun mediatic. Shef opozite që gatuan, që bën pazar si çdo qytetar hallemadh i këtij vendi, lidere e opozitës që, pasi ka gjuajtur me çizme në sallën e parlamentit, shfaqet “njerëzore”, flet për dobinë e seksit, dashurinë, e pastaj shfaqet te gatuan, po ashtu si ai tjetri, dhe bën ushtrime trupore në kuzhinë, shef qeverie që ulet këmbëkryq në livadhe, meditues dhe parashikues, e më tej nxjerr këpucën e grisur në dritare, një drejtues partie që, pasi ka heshtur disa muaj e vite dhe ka flirtuar herë majtas e herë djathtas, befaz rishfaqet si atdhetar i dorës së parë, kur është gati të shesë gjithçka për xhepin e tij dhe me ton trimi kërcënon se do t’ia hapë letrat shefit të qeverisë, drejtues të shumicës që befaz shfaqen si qehajatë e beut dhe janë kaq “gjynahqarë”, sa të vjen keq që janë munduar kaq shumë për ne...

Mjaft, se na e pështirosët! Në fund të fundit, megjithëse dihet se pushteti ju mban në këmbë, përpiguni, sadopak, të mbani një pjesë të kurrizit drejt sepse, në fund të fundit, kështu si shfaqeni, në mos tjetër, jeni të mëshiruar.

Ka qenë i pritshëm, megjithëse

kaloi çdo pritshmëri, mëria e opozitës ndaj disa deklaratave të liderit të dikurshëm socialist, Fatos Nano, në fakt prononcime të ditura. Mëria e tyre kaloi në tërbim, por e habitshme se si këta në pushtet aq shpejt kaluan në dëlir. A thua se nuk ishte fjala për të njëjtin Nano që e kanë përbuzur, mallkuar e ironizuar që nga shefi i partisë dhe deri tek ato që hapin e mbyllin dyert e selive. Tani, befaz, Nano u bë burrë i mirë, lider i madh, burrë shteti, trim, i pakorruptuar. Një kthesë e tillë është e vështirë për t’u mbajtur në mend, jo më për të ndryshuar një kurs në qëndrimin ndaj një njeriu, që kur ishte në qeverisje e përdori atë si një lojë dhe kur u largua nga pushteti shikoi përfitimet e tij.

Zonja Topalli, 16 vjet ishte figura e dytë e, më pas, e parë e Kuvendit të Shqipërisë; me këto cilësi shëtit gjithë botën, tallej si këta të Nusretit sot me foto duke u lazdruar nëpër rërat arabe, nxori jashtë sallës së parlamentit kë i deshi qejfi me një zhargon të padenjë, u qëndroi pa i luajtur qerpiku çasteve kur Meta kërcente mbi tryezat e parlamentit për ta kapur për gryke, opozita e sotme e kishte idhull, pozitës së sotme i tregoi plumbin ballit etj etj.

Tani kjo pozitë sheh me lakmi dhe shpresë nga ajo, si edhe nga Patozi dhe pret prej tyre. Kurse për opozitën ajo është Juda me fustan, e Patozi një hamzallëk i ri. Si mallra që, pasi përdoren, kthehen mbrapsht për ripërdorim.

Të gjithë këta që u përgjeronen njerëzve sot që t’u besojnë, në

fakt janë të pabesueshëm. Njëri më shumë, tjetri më pak, por të pabesueshëm. Si thotë populli, “merr njërin, shkapet për tjetrin”.

Një Bashë i provuar kaq herë, i përshtaqur si kopje e keqe e të parit të tij, të cilin deri dje e imitonte edhe në zërin e çjerrë si trimat e katundit apo në të ecurin me galop, sikur pengohet në gurët e ruginave. I njëjti Bashë i protestave me molotov dhe daljes budallaqe nga parlamenti; ky që braktis institucionet, tani kërkon të ndërtojë institucione dhe premtion t’i mbushë njerëzit me para të cilat nuk thotë as ku do të gjenden.

Në krahun tjetër shefi i qeverisë na kërkon të buzëqeshim, kur buzët janë ngrirë. Në tetë vjet qeshëm rrallëherë e u mjeruam shpeshherë. E di që duhet të zgjedhim të keqen më të vogël dhe e keqja më e vogël është ai. Nuk kemi rrugë tjetër. Ose nga ajo, me demek, e majta; ose nga ajo, me demek, e djathta. Nuk janë as idealistë dhe as vizionarë; janë parapolitikantë e një vendi, të cilin e kanë shqyer deri në rrënjë. Nëse nuk do të ishin në politikë, nuk do të ishin asgjë; dy prej tyre do të ishin ende sot jashtë Shqipërisë: njëri në Holandë, tjetri në Francë.

Të tjerët do të ishin si njerëz të zakonshëm, hallexhinj dhe jo sundues. Me përjashtime të pakta, asnjëri prej tyre nuk shquhet për mendim intelektual sipëror, ama janë makiavelistë të dorës së parë. Kambanat po bien me të madhe. Jo për të na zgjuar, por për të na shurdhuar. Edhe një herë, si gjithë këto tridhjetë vjet.

Pozherani bëhet me autoambulancë të re

VITI, 14 SHKURT (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar Qendrën e Mjekësisë Familjare në Pozheran të Vitisë. Me këtë rast, Zemaj, që ishte i shoqëruar edhe nga kryetari i kësaj komune, Sokol Haliti, i kanë dhuruar QKMF-së “Nënë Tereza” një autoambulancë. Zemaj ka thënë se do ta vazhdojnë mbështetjen edhe të qendrave të tjera komunale të cilat kanë nevojë për

shërbime emergjente.

Kryetari i Komunës, Haliti, ka pranuar zyrtarisht autoambulancën e cila do të shërbejë për ofrimin e ndihmës sa më të shpejtë për qytetarin. Ai ka thënë se furnizimi me një autoambulancë të re për këtë qendër ka qenë i domosdoshëm, për qëllim të ngritjes së cilësisë për shërbime shëndetësore urgjente.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Myles dhe Hajrizi: Luajmë vetëm për fitore

Dy basketbollistët e Kosovës, Divine Myles dhe Drilon Hajrizi, besojnë se “dardanët” do të shënojnë fitore në dy ndeshjet e radhës kundër Luksemburgut dhe Sllovakisë dhe të kualifikohen tutje. “Nuk luajmë asnjëherë për humbje, por vetëm për fitore. Kemi luajtur më parë ndaj Luksemburgut dhe Sllovakisë dhe i njohim. Besoj se gjasat janë të mira për të fituar”, ka deklaruar Myles



PRISHTINË, 14 SHKURT - Divine Myles është rikthyer te Kosova dhe premtom maksimumin. Ai është i lumtur që luan për “dardanët”, si amerikani i vetëm i natyralizuar. “Jam shumë i lumtur që jam rikthyer në Përfaqësuesen e Kosovës. Të përfaqësoj Kosovën. Po përmirësohem nga dita në ditë. Po ndihem shumë mirë dhe shpresoj se do të fitojmë ndaj Luksemburgut dhe Sllovakisë”, ka thënë Myles, i cili beson se kanë gjasat të mira për t’u kualifikuar tutje. “Nuk luajmë asnjëherë për humbje, por vetëm për fitore. Kemi luajtur më parë ndaj Luksemburgut dhe Sllovakisë dhe i njohim. Besoj se gjasat janë të mira për të fituar”, ka deklaruar Myles.

“Dardanët” do të luajnë në shtëpi përballë Luksemburgut (18 shkurt) dhe Sllovakisë (20 shkurt), në ndeshjet e fundit në Grupin B. Nëse “dardanët” shënojnë dy fitore në dy takimet e zhvilluara, atëherë do të kualifikohen në rrethin e ardhshëm. Të gjitha ndeshjet e Dritares së Tretë të Grupit B do të zhvillohen në Prishtinë. Ky ishte vendimi i mëhershëm nga Bordi i FIBA Evropës, duke i besuar edhe një ngjarje të rëndësishme Federatës së Basketbollit të Kosovës. Ndërsa basketbollisti tjetër i Kosovës, Drilon Hajrizi, beson në rezultate pozitive në përballje me Luksemburgun dhe Sllovakinë. Hajrizi për shkak të një lëndimi të vogël, nuk u stërvit të enjten,

megjithatë është optimist se do të kualifikohen në rrethin e ardhshëm. “Stërvitjet janë duke shkuar në mënyrën më të mirë të mundshme, edhe pse ende nuk jemi të kompletuar. Neve na mbetet të punojmë kështu si jemi duke punuar. Kemi cilësi. Gjithashtu, edhe disa lojtarë të rinj janë bashkuar, por edhe disa që na kanë munguar në nëntor na janë bashkangjitur”, është shprehur Hajrizi. Edhe pse pa tifozë, “dardanët”

luajnë vetëm për fitore. “Kemi cilësi të vazhdojmë tutje. Sa i përket ndeshjeve, unë jam i bindur se do të angazhohemi maksimalisht, ndërsa sa i përket cilësisë është e barabartë dhe do të vendosin detajet për të kaluar tutje. Fatkeqësisht pa tifozë, por do të mundohemi ta shfrytëzojmë përparësinë e terrenit vendas”, ka deklaruar Drilon Hajrizi. “Dardanët” do të luajnë në shtëpi përballë Luksemburgut

(18 Shkurt) dhe Sllovakisë (20 shkurt) në ndeshjet e fundit në Grupin B.

ORARI

**Më 18 shkurt takohen:
16:00 Sllovakia-Islanda
19:00 Kosova-Luksemburgu**

**Më 20 shkurt takohen:
16:00 Luksemburgu-Islanda
19:00 Kosova-Slovakia**

Fitojnë Drita, Prishtina dhe Ballkani. Sot zhvillohen dy ndeshje

PRISHTINË, 14 SHKURT - Të shtunën ka filluar stinori pranveror në Superligën e Kosovës në futboll, ku janë zhvilluar tri ndeshje nëpër mot të ftohtë dhe me reshje bore. Skuadra kampione në fuqi, Drita, ka shënuar fitore në duel me Llapin, në ndeshjen e zhvilluar në Gjilan me rezultat 1-0. Golin e vetëm të kësaj ndeshjeje e ka shënuar Astrit Fazliu në minutën e 74-t. Fitore në shtëpi ka realizuar edhe Prishtina, e cila në stadiumin “Fadil Vokrri” e ka mundur Drenicën me shifrat 3-1. Alban

Shillova i zhbllkoi shifrat e kësaj ndeshjeje në minutën e 13-të, por rezultatin e barazoi Dos Santos në minutën e 44-t. Në pjesën e dytë Prishtina u tregua më efikase dhe arriti që të shënojë edhe dy herë nëpërmjet Leonit Abazit, në minutën e 62-të dhe Gentian Muçës, në minutën e 71-të. Ndërkaq, Ballkani shënoi fitore si mysafir në Brestovik në duel me Besën, me rezultat bindës 3-0. Golat për portokallzinjtë i shënuan Edvin Kuç (22’) dhe Blend Baftiu (44’, 45’). Të dielën nuk është zhvillu-

SUPERLIGA - Java 19

**Drita - Llapi 1-0
Prishtina - Drenica 3-1
Besa - Ballkani 0-3
Të hënën takohen:
13:00 Feronikeli - Gjilani
13:00 Trepça '89 - Arbëria**

ar asnjë ndeshje për shkak të zgjedhjeve parlamentare, kurse sot (e hënë) zhvillohen dy ndeshjet e tjera, ku takohen Feronikeli - Gjilani dhe Trepça '89 - Arbëria.



Bora shtyn ndeshjet në futbollin e Shqipërisë

TIRANË, 14 SHKURT - Reshjet e dëborës kanë “pushtuar” gjithë Shqipërinë dhe kanë bërë të vështirë transportin si dhe kanë mbuluar fushat e të gjithë stadioneve, duke e bërë të pamundur zhvillimin e ndeshjeve. Si pasojë, me anë të një njoftimi në faqen zyrtare,

FShF-ja zbulon pezullimin e të gjitha ndeshjeve të futbollit deri të shtunën e ardhshme, duke përfshirë edhe Superiorene që ishte planifikuar të luhej të mërkurën. “Moti i keq dhe reshjet e dëborës që kanë përfshirë të gjithë vendin tonë kanë detyruar Federatën

Shqiptare të Futbollit që t’i shtyjë të gjitha ndeshjet e parashikuara për këtë javë. Federata e Futbollit ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me drejtuesit e të gjitha klubeve dhe është njohur me situatën e rënduar të terreneve sportive dhe stadioneve ku do të

zhvilloheshin shumë ndeshje. Duke vlerësuar këtë situatë, Federata Shqiptare e Futbollit ka marrë vendimin që t’i shtyjë ndeshjet e futbollit në të gjitha nivelet e kampionateve deri të shtunën e ardhshme, datë 20 shkurt 2021. Ndeshjet e parashikuara për t’ua luajtur



këtë të diel dhe gjatë javës do të luhen në një datë të mëvonshme, që do të përcaktohen nga sektori i garave në FShF”, thuhet në njoftimin e FShF-së.

Upamecano edhe zyrtarisht lojtar i Bayernit

MUNCHEN, 14 SHKURT - Dayot Upamecano është lojtari më i ri i Bayern Munichut. Lajmin e ka dhënë klubi "bavarez" ndërmjet uebfaqes zyrtare të klubit. Ditë më parë gazetari italian Fabrizio Romano

kishte raportuar se Bayerni dhe Leipzigu kishin arritur marrëveshje për transferimin e Upamecanos në "Allanz Arena", por asgjë nuk u zyrtarizua nga klubet. Tani është zyrtare, edhe drejtori

sportiv i Bayernit, Hasan Salihamidziq, komentoi transferimin e 22-vjeçarit në "Allanz Arena". "Ne jemi të lumtur që kemi mundur të transferojmë Dayot Upamecano te FC Bayern

Munchen. Dayot do të jetë një komponent shumë i rëndësishëm për skuadrën tonë në vitet e ardhshme. Ne jemi të bindur për këtë", u shpreh Salihamidziq në faqen zyrtare të klubit.



Derbi i takon Prishtinës, Llapi merr fitore të madhe ndaj Drenicës

PRISHTINË, 14 SHKURT - Prishtina e ka fituar kryendeshjen e javës së 16-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Të shtunën në kryeqytet, Prishtina fitoi ndaj Trepçës me rezultat 32:25. Me fitore Prishtina përforcohet në vendin e dytë me 25 pikë. Trepça ka rënë në pozitën e katërt me 19 pikë. Në vend të tretë është ngritur Kastrioti që e mposhti Vushtrrinë me 38:28. Kastrioti i ka 20 pikë. Fitore të rëndësishme shënoi Llapi, që në Podujevë e mposhti Drenicën me rezultat bindës, 42:22. Llapi mbetet i parafundit, por tani i ka 8 pikë, vetëm dy më pak se Vushtrria që renditet e teta. Të shtunën janë luajtur ndeshjet e javës së 12-të të Superligës së hendbollisteve, me të cilën xhiro ka nisur stinori pranveror në kampionatin e Kosovës. Ndeshja më interesante u luajt në kryeqytet, ku u takuan Prishtina e Kastrioti i Ferizajt. Ndeshja nuk dha fitues,



përfundoi 28:28. Pas pjesës së parë Prishtina kishte dy gola epërsi, 16:14, por në të dytën u barazuan shifrat. Eduarta Kurteshi shënoi 9 gola për Prishtinën, kurse Adriana Salihu realizoi 10 herë për Kastriotin. Prishtina është e treta me 19 pikë, kurse Kastrioti mban vendin e katërt me 17 pikë. Lideri, Istogu, fitoi bindshëm ndaj Dritës (40:21), kurse kampioni aktual, Ferizaj, fitoi me dy gola dallim ndaj Shqiponjës në Gjakovë, 31:29.

Superliga - Meshkujt

| | |
|-----------------------|---------------|
| Zhegra - Besa Famgas | 17:42 (8:23) |
| Prishtina - Trepça | 32:25 (16:13) |
| Prizreni - Vëllaznimi | 31:35 (14:18) |
| Llapi - Drenica | 42:22 (22:11) |
| Kastrioti - Vushtrria | 38:28 (20:12) |

Superliga - Femrat

| | |
|------------------------|---------------|
| Jusuf Gërvalla - KEK-u | 34:21 (15:9) |
| Istogu - Drita | 40:21 (20:9) |
| Prishtina - Kastrioti | 28:28 (16:14) |
| Vjosa - Samadrexha | 20:35 (8:18) |
| Vëllaznimi - Vushtrria | 18:53 (7:27) |

Kloppi, favorit i basteve për shkarkim

LIVERPOOL, 14 SHKURT - Shtëpitë e basteve e kanë bërë trajnerin e Liverpoolit, Jurgen Klopp, një favorit të basteve për të qenë trajneri i radhës i Ligës Premierë që largohet nga klubi i tij. Klopp, i cili ka udhëhequr "Reds" drejt triumfit në Ligën e Kampionëve dhe Ligën Premierë në dy sezonet e fundit, ishte vlerësuar lart për punën e tij me klubin e madh anglez. Sipas "Betfair", trajneri gjerman kishte pasur një koeficient prej 10/1 për të qenë trajneri i radhës që do të largohej, por humbja 3-1 ndaj Leicester Cityt ka ndryshuar gjërat. Tani largimi i Kloppit nga "Anfield" kuotohet me një koeficient dukshëm më të ulët dhe ato shanse tani janë ulur në mënyrë drastike në 4/7. Nuk



ka asnjë sugjerim që Liverpooli po planifikon të shkarkojë shefin e tyre, por rezultatet negative mund t'i çojnë drejtuesit drejt një vendimi. Situata aktuale e "Reds" është njësoj me atë të Borussia

Dortmundit gjatë sezonit të fundit të Kloppit në krye të klubit gjerman. Pas një fillimi të dobët në sezonin 2014-15, Kloppi njoftoi në prill se do të largohej nga gjigantët e Bundesligas në fund të sezonit.

Pochettino: Do të jetë vështirë ndaj Barcelonës

Trajneri i Paris Saint Germainit, Maurizio Pochettino, është shprehur i kënaqur me arritjen e fitores ndaj Nice dhe me kryesimin e Ligës 1, por theksoi se nuk do jetë lehtë ndaj Barcelonës. PSG-ja mundi skuadrën e Nices me

rezultat 2-1 për ta marrë kryesimin e Ligës 1 me pikë të barabarta me Lille i cili po përjeton një formë fantastike këtë sezon. Pochettino u shpreh i kënaqur me fitoren ndaj Nices. Ai theksoi se në ndeshjen ndaj Barcelonës që do të zhvillohet

në mesjavë nuk do të jetë fare lehtë. "Të gjitha ndeshjet janë të vështira. Unë mendoj se jemi kthyer nga një situatë e vështirë, me 10 ndeshje të luajtura në më pak se 40 ditë. është e vështirë me të gjitha problemet që lidhen me Covid-19 dhe këtë

periudhë mjaft të veçantë", ka thënë ai. "Kjo është arsyeja pse ne jemi të kënaqur me tri pikët dhe, në përgjithësi, me fitoren dhe paraqitjen e bërë me profesionalizëm. Jam i kënaqur me paraqitjen dhe mentalitetin e

lojtarëve. Ne po luftojmë dhe po përpiqemi të fitojmë. Tani duhet të fokusohemi në ndeshjen e Ligës së Kampionëve në Barcelonë. Do të jetë e vështirë sepse do të luajmë edhe një herë një ekip shumë të mirë", ka deklaruar Pochettino.

SHKURT

Ronaldo: Kjo humbje nuk do të na rrezojë

Pas humbjes së Juventusit 1-0 ndaj Napolit në stadiumin "Diego Armando Maradona", ka reaguar Cristiano Ronaldo me anë të një postimi në profilin e vet zyrtar në rrjetin social "Instagram", duke deklaruar se kjo nuk është një humbje që do t'i rrezojë. "Kjo humbje nuk do të na rrezojë. Me kokën lart dhe të mendojmë për Ligën e Kampionëve", ka thënë Ronaldo.

Koeman: Jemi gati për PSG-në

Trajneri Ronald Koeman ka thënë se Barcelona është gati për sfidën e Ligës së Kampionëve pas fitores 5-1 të marrë në La Liga kundër Alavesit. Strategu i katalanasve është shprehur se ndeshja me PSG-në vjen në momentin e tyre më të mirë. "Ndeshja me PSG-në vjen në momentin më të mirë. Jemi në një moment të mirë dhe jam i bindur se do të jetë një sfidë e ekuilibruar. Më mirë të mos flas më për VAR. Duhet të kemi një lente zmadhuese për të parë nëse ishte pozicion jashtë loje ose jo. I kam parë disa herë pamjet dhe mendoj se nuk ishte pozicion jashtë loje", ka deklaruar Koeman.

Reali bën ofertë për Haalandin

Erling Haaland i cili është një nga sulmuesit më të mirë në qarkullim sezonet e fundit, kërkohet me shumë insistim nga klubet e mëdha evropiane, në krye me Realin e Madridit. Sipas gazetës prestigjioze iberike "AS", presidenti i klubit mbretëror Florentino Perez po përgatit sulmin për në merkato verore për sulmuesin norvegjez. Sipas asaj që shkruan media spanjolle, skuadra merengues pritet të derdhë në arkat e klubit të Borussia Dortmundit 150 milionë euro. Një shifër e çmendur duke parë krizën financiare që ka kapluar çdo klub të madh në kontinentin e vjetër. Haaland në këtë sezon është aktivizuar në total në të gjitha kompeticionet me klubin verdhezi në 22 ndeshje duke realizuar 22 gola, me një mesatare 1 gol për çdo ndeshje.

Pioli: Spezia fitoi me meritë

Stefano Pioli pretendon se kjo ishte 'disfata e parë e merituar' e Milanit në Serinë A, pasi u mposht nga Spezia në çdo mënyrë. "Rossonerët" pësuan humbjen e tyre të tretë në këtë sezon të Serisë A dhe atëherë kur pritej më së paku. Kjo do të ishte fundjava kur ata shfrytëzuan humbjen e Juventusit ndaj Napolit dhe Interit me një provë të ndërlikuar kundër Lazios, por në vend të kësaj ata dështuan keq. Pas ndeshjes, Pioli deklaroi se kjo ishte humbja e tyre e parë e merituar në këtë edicion. "Sigurisht se duhet të reagojmë dhe do të bëjmë. Spezia fitoi me meritë. Kjo është humbja jonë e parë e merituar e sezonit, pasi nuk kishim mjaft cilësi apo intensitet, kështu që kundërshtarët tanë me të drejtë shfrytëzuan avantazhin", ka thënë Pioli.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



Sot u bënë një vit pa më të dashurën tonë



Shefkije Preniqi Misini

(15.03.1945-15.02.2020)

Të rënda qenkan ditët kur mungon prania jote. Në këtë përvjetor qenka shumë vështirë të shkruajmë për ty, por megjithatë jemi krenare që patëm një nënë, gjyshe, motër, vjehërr siç ishe ti. Dashuria, mirësia dhe urtësia që kishe ndaj familjes dhe farefisit, na bën që mos të harrojmë kurrë.

Të jetosh në zemrat e atyre që lë pas, do të thotë të mos vdesësh kurrë.

Gjithmonë krenarë që të patëm dhe shumë të pikëlluar që të humbëm.

Edhe pse nuk je më fizikisht me ne, në zemrat tona do të jetosh gjithmonë.

Të kujtojnë me shumë mall: djemtë, vajzat, motra, rejat, nipat dhe mbesat.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

